

SHOQËRIA "ABISSNET" SHA
NIPT: K01417001C
ADRESA E SELISË: "ISMAIL QEMALI",
PLL.18, K.II, TIRANË

VENDIM NR. 81/L
DATE 03.11.2023
I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË AKSIONARËVE
TË SHOQËRISË "ABISSNET" SHA

Sot, më datë 03.11.2023, ora 10:00, në adresën: Rruga "Ismail Qemali", Pallati 18, Tiranë, mbahet mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve të shoqërisë "Abissnet" sh.a. Në këtë mbledhje është i pranishëm aksionari i vetëm i shoqërisë "Abissnet" sh.a., shoqëria "2K Group" shpk, e cila zotëron 100% të kapitalit të shoqërisë "Abissnet" sha, përfaqësuar personalisht nga ortakët e saj si më poshtë:

- Z. Koço Kokëdhima, i cili zotëron 65% të kapitalit të shoqërisë;
- Znj. Brixhilda Kokëdhima, e cila zotëron 35% të kapitalit të shoqërisë;

Kjo mbledhje e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve u thirr për të diskutuar çështjet e përfshira në rendin e ditës, të njoftuar paraprakisht aksionarëve, si më poshtë:

1. Miratimi i Raportit të Zmadhimit të Kapitalit të shoqërisë "Abissnet" sh.a., për vitin 2022, të përgatitur nga audituesi ligjor, Engjëllushe Rami, me Licencë nr. 259, datë 27.08.2012, NUIS L32109025F.

Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve, pasi shqyrtoi çështjet e përfshira në rendin e ditës,

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e Zmadhimit të Kapitalit, përgatitur nga audituesi ligjor Engjëllushe Rami, me Licencë nr. 259, datë 27.08.2012, NUIS L32109025F.
2. Sipas bilancit vjetor të shoqërisë "Abissnet" sh.a., për vitin 2022, shoqëria rezulton me fitim në shumën 20,981,527 (njëzet milion e nëntëqind e tetëdhjetë e një mijë e pesëqind e njëzet e shtatë) Lekë.

Ky fitim është destinuar në këtë mënyrë:

- Shuma prej 1,081,527 (një milion e tetëdhjetë e një mijë e pesëqind e njëzet e shtatë) Lekë të destinohet për fondin e rezervës ligjore.
- Shuma prej 19,900,000 (nëntëmbëdhjetë milion e nëntëqind mijë) Lekë të destinohet për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë përmes emetimit të 19,900 (nëntëmbëdhjetë


mijë e nëntëqind) aksioneve të reja me vlerë nominale 1,000 (një mijë) Lekë për aksion.

Pas këtij zmadhimi, kapitali i shoqërisë "Abissnet" sh.a. bëhet 713,300,000 (shtatëqind e trembëdhjetë milion e treqind mijë) aksione me vlerë nominale 1,000 (një mijë) Lekë secili, të zotëruar nga aksionarët sipas tabelës së mëposhtme:

Nr	Aksionerët	ISHTE			BËHET		
		Numri i aksioneve	% pjesëmarrjes	Kontributi në Lekë	Numri i aksioneve	% pjesëmarrjes	Kontributi në Lekë
1	2K Group shpk	693,400	100	693,400,000	713,300	100	713,300,000
	Shuma	693,400	100	693,400,000	713,300	100	713,300,000

**SHOQËRIA "ABISSNET" SHA
AKSIONARI I VETËM
"2K GROUP" SHPK
Përfaqësuar nga ortakët**

Koço KOKËDHIMA



Brixhilda KOKËDHIMA

